



Arrestohen dy gjilanas, gjuajtën me armë zjarri në dasmë

KRONIKA | August 04, 2022 - 10:40

SHPËRNDAJE:  

Policia e Kosovës në rajonin e Gjilanit ka njoftuar se sot gjatë ditës ka pranuar një informatë se në fshatin Bresalc janë dëgjuar të shtëna me armë zjarri.

Patrulla policore dhe Njësi Rajonal për Reagim të Shpejtë kanë arritur të lokalizojnë vendin e ngjarjes, ku kanë arrestuar të dyshuarit, shqiptar – kosovar, A.S. (1997) dhe A.A. (1957).

Sipas njoftimit, pas arritjes së policisë në vendin e ngjarjes si prova materiale janë gjetur dy armë, njëra e llojit “Ekol Firat Compact” e kalibrit 9 mm dhe tjetra “Bereta Pb” e kalibrit 9 mm, tridhjetë e shtatë (37) gëzhoja të kalibrit 9 mm dhe tre (3) fishekë të kalibrit 9 mm.

“Derisa të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt me urdhër të prokurorit, rasti është cilësuar si ‘Armëmbajtje pa leje’ dhe ‘Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm’”, thuhet në njoftimin e PK-së, raporton Zeri.info.


“Drejtoria Rajonale Gjilan, Stacioni Policor Gjilan, më datën 04/08/2022 ka pranuar një informatë se në fshatin Bresalc janë dëgjuar të shtëna me armë zjarri. Patrulla policore dhe Njësi Rajonal për Reagim të Shpejtë (NJRSH) ka arritur që të lokalizoj vendin e ngjarjes, ku kanë takuar të dyshuarin Shqiptar Kosovar A.S. (1997) dhe A.A. (1957)”.

Po ashtu bëhet e ditur se në vendin e ngjarjes janë gjetur prova materiale se të dyshuarit gjatë një ahengu familjar (dasmë) kanë shtënë disa herë me armë zjarri.

Sipas njoftimit të PK-së po ashtu thuhet se nga të dyshuarit janë konfiskuar dy armë, njëra e llojit „Ekol Firat Compact” e kalibrit 9mm, dhe tjetra „Bereta Pb” e kalibrit 9 mm, (37) gëzhoja te kalibrit 9 mm dhe (3) fishekë të kalibrit 9 mm si dëshmi materiale për Gjykatë.


Ndryshe Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan vazhdon të apelojë te të gjithë qytetarët që të festojnë me zemër, jo me armë. Sa më pak armë, më pak viktima. /Zëri

Të rekomanduara



Vdes një person në Bogë, u godit nga një...

August 04, 2022



Arrestohet 39-vjeçari që kanosi zyrtarët...

August 04, 2022

Mashtronin mërgimtarët me bileta, arrestohen bashkëpronarët e “Prishtina Jet”

KRONIKA | August 04, 2022

Sulmoi seksualisht një femër nga Moldavia, arrestohet vitiasi

KRONIKA | August 04, 2022

Paraburgim gjilanasit që shfrytëzoi për prostitucion një femër me probleme psikike

KRONIKA | August 03, 2022

Sulmoi dy roje pyjesh në Kaçanik, arrestohet 56-vjeçari

KRONIKA | August 03, 2022

U vazhdohet paraburgimi edhe për nga dy muaj Nuredin Lushtakut dhe dy të tjerëve

KRONIKA | August 03, 2022

Pushuesit braktisin plazhin ku ndodhi tragjedia me shtatëvjeçaren në Himarë


KRONIKA | August 03, 2022

Më të lexuarat




KRONIKA | August 04, 2022

Mashtronin mërgimtarët me bileta, arrestohen bashkëpronarët e “Prishtina Jet”



KRONIKA | August 03, 2022

Leojoi pasagjerin të dalë nga dritarja, policia identifikon dhe gjobit shoferin në Gjakovë



KRONIKA | August 03, 2022

U vazhdohet paraburgimi edhe për nga dy muaj Nuredin Lushtakut dhe dy të tjerëve




KRONIKA | August 03, 2022

Paraburgim gjilanasit që shfrytëzoi për prostitucion një femër me probleme psikike



KRONIKA | August 03, 2022

Rrahje mes pesë personave në Obiliq, dy bëhen për spital



KRONIKA | August 03, 2022

Pushuesit braktisin plazhin ku ndodhi tragjedia me shtatëvjeçaren në Himarë